# Shpërndarja e Ushqimeve të Lehta dhe Buzëqeshjeve

**Ne jemi Semi dhe Anastasia** dhe përpiqemi që TA LËMË TË SHNDRITË DRITËN TONË duke ndarë me të tjerë!





1

**Si Mund të Ndihmojmë?**
Atje ku jetojmë, në Florida, SHBA, ne shohim plot njerëz që janë të pastrehë. Ne vrisnim mendjen se si mund t'i ndihmonim. Jezusi ushqeu njerëz që ishin të uritur, dhe çdo njeri ka nevojë të ushqehet! Kështu vendosëm të bënim komplete ushqimesh të lehta për raste të ngutshme.

FIGURA NGA PLAZHI NGA GETTY IMAGES






2

**Blerja e Furnizimeve**
Miku ynë Xhoa na ndihmoi të blinim furnizime te dyqani njëdollarësh.

3

**Bërja e Kompleteve**
Ne futëm shufra drithërash, shkopinj buke me djathë dhe ushqime të tjera të lehta e të shijshme në kompletet tona. Semi madje e provoi një!



4

**Mrekulli!**
Shpërndarja e kompleteve tona na bëri të buzëqeshim. Disa njerëz thanë: "Faleminderit!" dhe "Mrekulli!"



5

**Plot Komplete të Tjera**
Nëna jonë e vendosi projektin në internet dhe dega e të rinjve në moshë madhore beqarë mësoi rreth tij. Ata bënë 100 komplete të tjera ushqimesh të lehta për strehën tonë vendore të të pastrehëve. Streha i përdori ato për të ftuar njerëz të regjistroheshin në një program në ndihmë të tyre për të marrë shtëpi. Kjo na bëri vërtet të lumtur!

## SI MUND TË SHNDRITËSH TI?

- Zgjidh një projekt shërbimi që dëshiron ta bësh me familjen tënde.
- Jep një ofertë agjërimi në zarfin tënd të së dhjetës. Paratë e tua do të shkojnë për të ndihmuar dikë në nevojë.

## NA DËRGO NJË YLL!



Si e lë ti dritën tënde të shndritë, ashtu siç na kërkoi Jezusi të bënim? Na dërgo një yll me historinë tënde, fotografi dhe lejen e prindit. Shih faqen 71 për më shumë informacion.